



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT TË GJYKATAVE DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
DREJTORIA E IT DHE MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2023

Lënda: Kthim përgjigje, kërkesës për informacion

Në përgjigje të kërkesës për informacion, përcjellë nga ana juaj sipas komunikimit elektronik, protokolluar me tonën nr. 6549 Prot, datë 22.12.2023, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 15, të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë operojnë me dy sisteme të ndryshme elektronike për menaxhimin e çështjeve gjyqësore, sistemi i menaxhimit të çështjeve ICMIS i cili përdoret nga të gjitha gjykatat që prej vitit 2007, me përjashtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të cilat operojnë me sistemin ARKIT që prej vitit 2000.

Moduli i shortimit elektronik të çështjeve gjyqësore ka qenë dhe është pjesë e sistemeve elektronike të menaxhimit të çështjeve gjyqësore që nga krijimi i këtyre sistemeve.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 118, pika 1, 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 25, pika 3, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 2, shkronja “ë”, nenin 94, pika 4, si dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “c”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka miratuar vendimin nr. Nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” të cilin e gjeni në linkun <https://klgj.al/wp-content/uploads/2023/01/VENDIM-Nr.554dat%C3%AB-29.12.2022-P%C3%8BR-NDARJEN-ME-SHORT-T%C3%8B-%C3%87%C3%8BSHTJEVE-GJYQ%C3%8BSORE.pdf>

Në këtë vendim ndahen qartë përgjegjësitë e kryetarit të gjykatës, i cili ka detyrimin të planifikojë seancat e ndarjes së çështjeve me short, seanca të cilat janë parashikuar të realizohen çdo ditë pune. Në mënyrë përjashtimore është parashikuar shtyrja e shortimit për ditën vijuese të punës në rastet e pamundësisë objektive të realizimit të shortit elektronik, kjo për të limituar aplikimin e shortit manual vetëm në rastet e problemeve serioze të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve. Tjetër kompetencë e Kryetarit të Gjykatës është e drejta e caktimit të afatit të pezullimit të shortit ndërsa rastet janë parashikuar në mënyrë taksative në vendim.

Është parashikuar përgjegjësia e kancelarit të gjykatës i cili duhet të mbikëqyrë përgatitjen e çështjeve të cilat do t'i nënshtrohen procesit të shortimit elektronik, procedurën e shortimit si dhe kalimin e çështjes gjyqtarit relator.

Parashikohen gjithashtu aspektet e përgjithshme të publicitetit dhe transparencës së procesit të shortimit të tilla si realizimi në një sallë gjykimi, shfaqja në monitorët e gjykatës si dhe publikimi në faqen zyrtare të internetit të raportit të shortit, i cili është rezultati i krijuar përmes shortimit.

Procesi i shortimit elektronik të çështjeve nuk zhvillohet nga Operatorët Ekonomikë por nga Kryetari i Gjykatës respektive, dhe ndarja e çështjeve me short si rregull, realizohet çdo ditë pune në rrugë elektronike, me anë të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 554, datë 29.12.2022 “Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore” të sipërcituar.

Në këto kushte nuk mund të përcaktohet asnjë vlerë financiare mbi këtë modul pasi ky modul informatik ka qenë gjithmonë pjesë e sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore që nga krijimi i tyre.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.